



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
Drejtoria e Buxhetit dhe Financës

Nr. 14257 Prot

Lezhë, më 10. 07. 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. —, Datë 10. 07. 2026

**PËR MIRATIMIN E TAVANEVE TË SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE
BUXHETORE PËR PBA-në 2027-2029 (Faza e Dytë).**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; dhe në zbatim të ligjit nr.68, datë 24.07.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit Plotësues të Ministrit Financave nr.17, datë 10.07.2026 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029”, Kryetari i Bashkisë, i propozon Këshillit të Bashkisë;

Për të vendosur:

- 1.Miratimin e Tavaneve të Shpenzimeve sipas Programeve Buxhetore për PBA-në 2027-2029 (Faza e Dytë), sipas aneksit dhe relacionit përkatës, bashkëlidhur këtij projektvendimi.
- 2.Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet GMS-ja dhe drejtuesit e EMP-it.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139, datë 27.12. 2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI

Pjerin Ndreu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Drejtoria e Buxhetit dhe Financës

Nr. 14257 / Prot

Lezhë, më 10. 07.2026

RELACION

Mbi përgatitjen dhe miratimin e Tavanëve sipas Programeve Buxhetore për PBA-në 2027-2029 për Fazën e Dytë.

Të nderuar këshilltarë!

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka përgatitur projekt/dokumentin për tavanet e shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2027-2029 për fazën e dytë, në mënyrë analitike dhe të strukturuar, bazuar në kërkesat e ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, të procedurave të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, dhe në Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr.17, datë 10.07.2026 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029”.

Projekt/dokumenti i tavanëve të PBA-së paraqet një prezantim të programeve buxhetore dhe nivelin e shpenzimeve sipas grup strukturës ekonomike, ku mundëson realizimin e funksioneve të veta dhe të deleguara. Projekt/dokumenti i tavanëve të PBA-së jep një informacion për programet dhe financimin e tyre për tre vitet e ardhshme 2027-2029. Në këtë projekt/dokument paraqitet në mënyrë të detajuar plani financiar i të ardhurave dhe shpenzimeve për tre vitet e ardhshme, sipas programeve.

Në këtë fazë të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, e cila është faza teknike, merret vendimi për tavanet e qëndrueshme, të bazuar në politikat e zhvillimit, të cilat duhen respektuar gjatë fazës finale.

Për përcaktimin e tavanëve janë marrë në konsideratë të dhënat e shpenzimeve të realizuara dhe të parashikuara për periudhën 3 vjeçare 2024-2026, të dhënat mbi të ardhurat që krijohen nga burimet e veta (taksa e tarifa), taksat e ndara, transfertat nga burimet qendrore për vitet 2027-2029, politikat e zhvillimit për çdo program dhe

zbatimi i objektivave strategjikë të miratuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor.

Bazuar në raportin e vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave vendore, në transfertat e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për bashkinë Lezhë që jepen nga Qeveria Qëndrore, rezulton se burimet (të ardhurat) dhe shpenzimet janë për tre vitet e ardhshme 2027-2029 si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Sipas viteve		
		2027	2028	2029
I	BURIMET GJITHSEJ	2,612,780	2,703,785	2,754,609
I.a	Nga Burimet e Veta	1,508,972	1,561,421	1,576,951
1	Të ardhurat nga taksat vendore	1,012,000	1,049,500	1,059,995
2	Të ardhurat nga tarifatat vendore	322,603	337,552	340,843
3	Të ardhurat e tjera	174,369	174,369	176,113
I.b	Të ardhurat nga taksat e ndara	97,500	105,500	106,555
I.c	Nga Burimet Qëndrore	1,006,308	1,036,864	1,071,103
1	Transferta e Pakushtëzuar	540,089	570,645	601,224
2	Transferta Sektoriale	365,991	365,991	369,651
3	Transferta Sektoriale për rritje pagash	100,228	100,228	100,228
II	SHPENZIMET GJITHSEJ	2,612,780	2,703,785	2,754,609
II.a	Shpenzimet për Tavanet Buxhetore	2,595,780	2,685,785	2,735,609
II.b	Fondi Rezervë dhe i Kontigjencës	17,000	18,000	19,000

☞ Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore për tre vitet e ardhshme janë pasqyruar në përputhje me të dhënat e miratuara nga Këshilli i Bashkisë me vendimin nr.16, datë 25.02.2026. Për vitin 2027 parashikohet një rritje e të ardhurave rreth 4.4% ose 64,103 mijë lekë më shumë në krahasim me vitin 2026; për vitin 2028 parashikohet një rritje e të ardhurave rreth 3.5% ose 52,449 mijë lekë më shumë në krahasim me vitin 2027 dhe për vitin 2029 parashikohet një rritje e të ardhurave 1% ose 15,531 mijë lekë më shumë në krahasim me vitin 2028.

☞ Transferta e Pakushtëzuar për vitin 2027 parashikohet me një rritje në vlerë absolute në shumën 29,656 mijë lekë ose 4.8% në krahasim me vitin 2026, për vitin 2028 parashikohet me një rritje në vlerë absolute në shumën 30,556 mijë lekë ose 4.8% më shumë se viti 2027, dhe për vitin 2029 parashikohet me një rritje në vlerë absolute në shumën 30,878 mijë lekë ose 4.6% më shumë se viti 2028.

☞ Transferta sektoriale për vitet 2027-2028 është parashikuar me një rritje 2% ose në vlerën 7,176 mijë lekë më shumë, ndërsa për vitin 2029 është parashikuar me një rritje 3% ose në vlerën 10,836 mijë lekë më shumë, këto krahasuar me vitin 2026.

☞ Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transfertat e pakushtëzuar sektoriale për periudhën 2027-2029 janë parashikuar, referuar Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr.17, datë 10.07.2026 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”.

☞ Të ardhurat nga Transfertat e Qeverisjes Qëndrore për vitin 2027 janë me një rritje

36,832 mijë lekë ose 3.8% më shumë në krahasim me vitin 2026, për vitin 2028 parashikohet me një rritje 30,556 mijë lekë ose 3% në krahasim me vitin 2027, dhe për vitin 2029 parashikohet me një rritje 34,239 mijë lekë ose 3.3% në raport me vitin 2028.

Në përcaktimin e tavaneve përgatitore është përdorur metodologjia e buxhetimit mbi bazë programi dhe produkti (BPP) duke siguruar lidhje midis burimeve (input-ve), produkteve, rezultateve mbi bazën e politikave dhe objektivave për çdo program buxhetor, si dhe kostove për çdo aktivitet.

Projekt/dokumenti i tavaneve buxhetore bën pasqyrimin e shpenzimeve për 8 fushat bazë, për 8 programe të miratuar dhe për 29 funksione, ku respektivisht jepen të dhëna në vlerë dhe përqindje për programet buxhetore si më poshtë:

Kodi	Programi/Funksioni	Në mijë lekë					
		2027		2028		2029	
		Në vlerë	Në % / totalit	Në vlerë	Në % / totalit	Në vlerë	Në % / totalit
AA127	Shërbime Adiministrative/Menaxhetiale	324,418	12.4	337,097	12.5	330,693	12.0
AB127	Rendi dhe Siguria Publike	117,453	4.5	119,810	4.4	122,127	4.4
AC127	Çështjet e Përgjithshme Ekonomike	154,771	5.9	156,613	5.8	188,237	6.8
AD127	Infrastruktura, Mjedisi e Shërb.Publike	1,396,370	53.4	1,155,036	42.7	1,313,296	47.7
AE127	Turizmi dhe Kultura	72,521	2.8	73,050	2.7	73,540	2.7
AF127	Arsimi, Rinia dhe Sporti	393,749	15.1	397,234	14.7	400,094	14.5
AG127	Përkujdesja Sociale dhe Strehimi	136,498	5.2	446,945	16.5	307,572	11.2
AH127	Fondi Rezervë dhe i Kontigjencës	17,000	0.7	18,000	0.7	19,000	0.7
TOTALI		2,612,780	100.0	2,703,785	100.0	2,754,609	100.0

Në lidhje me përcaktimin e tavaneve përgatitore të PBA-së 2027-2029, janë mbajtur parasysh edhe këto kritere bazë, si;

Parashikimi i shpenzimeve për investime, është bazuar në dokumentat strategjikë, e konkretisht në: Planin e Përgjithshëm Vendor, Strategjitë e Zhvillimit Vendor dhe Sektorial, prioritetet e miratuara nga ana Juaj, dhe duke respektuar kriteret prioritare dhe rregullat bazë për financimin e tyre.

☞ Angazhimet buxhetore, ku përfshihen të gjitha shpenzimet për kontratat e lidhur, siç janë investimet në proces, etj.

☞ Pesha e shpenzimeve kapitale dhe shërbimeve publike me burim financimi nga burimet e veta janë në rritje nga viti në vit, kjo për të mundësuar përmirësimin e shërbimeve dhe cilësinë e jetës së qytetarëve, respektivisht: në vitin 2027 ato rriten 3.4% në krahasim me vitin 2026, në vitin 2028 ato rriten 5.1% në krahasim me vitin 2027, dhe në vitin 2029 ato rriten 2.4% në krahasim me vitin 2028, duke ndjekur të njëjtin trend rritje të burimeve.

☞ Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore pësojnë rritje rreth 5.6% në vitin

2027, 1% në vitin 2028 dhe 1% në vitin 2029, kjo referuar politikave qendrore të rritjes së pagave, ndikimit të inflacionit dhe vjetërsisë në punë.

☞ Shpenzimet e tjera korrente kanë pësuar rritje ndër vite, kjo për arsye të rritjes së fondeve për shërbimet sociale, ndërsa shpenzimet administrative vijnë në ulje nga viti në vit.

☞ Në përcaktimin e tavanëve të shpenzimeve një vëmendje e vecantë është treguar edhe në përcaktimin e shpenzimeve për funksionin e Mbrojtjes Civile, ku shpenzimet në këtë nënprogram zënë mbi 4 % të buxhetit nga burimet e veta të bashkisë.

☞ Raporti i shpenzimeve gjithsej sipas viteve është:

- Për vitin 2027: -Pagat dhe sigurimet shoqërore zënë 39%, -Shpenzimet e tjera korrente zënë 22.9%, -shpenzimet kapitale zënë 38.1%.
- Për vitin 2028: -Pagat dhe sigurimet shoqërore zënë 38.1%, -Shpenzimet e tjera korrente zënë 22.2%, -shpenzimet kapitale zënë 39.7%.
- Për vitin 2029: -Pagat dhe sigurimet shoqërore zënë 37.8%, -Shpenzimet e tjera korrente zënë 21.9%, -shpenzimet kapitale zënë 40.3%.

☞ Raporti i shpenzimeve nga burimet e veta (Të ardhurat vendore + transferta e pakushtëzuar), pa transfertën sektoriale, sipas viteve është:

- Për vitin 2027: -Pagat dhe sigurimet shoqërore zënë 30.9%, -Shpenzimet e tjera korrente zënë 24.8%, -shpenzimet kapitale zënë 44.3%.
- Për vitin 2028: -Pagat dhe sigurimet shoqërore zënë 30.1%, -Shpenzimet e tjera korrente zënë 24.0%, -shpenzimet kapitale zënë 45.9%.
- Për vitin 2029: -Pagat dhe sigurimet shoqërore zënë 29.8%, -Shpenzimet e tjera korrente zënë 23.6%, -shpenzimet kapitale zënë 46.6%.

☞ Në mënyrë të detajuar dhe analitike jepen Tavanet sipas Programeve Buxhetore, bashkëlidhur projektvendimit.

KRYETARI

Pjerin Ndreu



Tavanet e Programeve Buxhetore

		2027	2028	2029
AA127	Shërbimet Administrative dhe Menaxheriale			
	Pagat dhe sigurimet shoqërore	237,980	240,360	242,763
	Të tjera shpenzime korrente	76,338	76,637	76,930
	Shpenzimet kapitale	10,100	20,100	11,000
	Tavanet e përgjithshme	324,418	337,097	330,693
AB127	Rendi dhe Siguria Publike			
	Pagat dhe sigurimet shoqërore	76,274	77,036	77,807
	Të tjera shpenzime korrente	41,179	42,774	44,370
	Shpenzimet kapitale	0	0	0
	Tavanet e përgjithshme	117,453	119,810	122,177
AC127	Çështjet e Përgjithshme Ekonomike			
	Pagat dhe sigurimet shoqërore	80,379	81,185	81,999
	Të tjera shpenzime korrente	60,392	60,428	60,464
	Shpenzimet kapitale	14,000	15,000	45,774
	Tavanet e përgjithshme	154,771	156,613	188,237
AD127	Infrastruktura, Mjedisi dhe Shërbimet Publike			
	Pagat dhe sigurimet shoqërore	224,972	227,222	229,494
	Të tjera shpenzime korrente	235,824	235,824	235,824
	Shpenzimet kapitale	935,574	691,990	847,978
	Tavanet e përgjithshme	1,396,370	1,155,036	1,313,296
AE127	Turizmi dhe Kultura			
	Pagat dhe sigurimet shoqërore	48,594	49,080	49,570
	Të tjera shpenzime korrente	21,130	21,173	21,173
	Shpenzimet kapitale	2,797	2,797	2,797
	Tavanet e përgjithshme	72,521	73,050	73,540
AF127	Arsimi, Rinia dhe Sporti			
	Pagat dhe sigurimet shoqërore	279,495	282,297	285,120
	Të tjera shpenzime korrente	110,754	111,437	111,474
	Shpenzimet kapitale	3,500	3,500	3,500
	Tavanet e përgjithshme	393,749	397,234	400,094
AG127	Përkujdesja Sociale dhe Strehimi			
	Pagat dhe sigurimet shoqërore	71,379	72,110	72,832
	Të tjera shpenzime korrente	34,705	34,722	34,740
	Shpenzimet kapitale	30,414	340,113	200,000
	Tavanet e përgjithshme	136,498	446,945	307,572
AH127	Fondi Rezervë dhe Fondi i Kontigjencës			
	Pagat dhe sigurimet shoqërore	0	0	0
	Të tjera shpenzime korrente	17,000	18,000	19,000
	Shpenzimet kapitale	0	0	0
	Tavanet e përgjithshme	17,000	18,000	19,000

TOTALI PAGAVE DHE SIGURIMEVE SHOQËRORE	1,019,073	1,029,290	1,039,585
TOTALI I SHPENZIMEVE TË TJERA KORRENTE	597,322	600,995	603,975
TOTALI I SHPENZIMEVE KAPITALE	996,385	1,073,500	1,111,049
TOTALI I TAVANEVE TË PËRGJITHSHME	2,612,780	2,703,785	2,754,609
MAKSIMUMI I TAVANIT	2,612,780	2,703,785	2,754,609
	0	0	0
FONDI REZERVE NË PËRQINDJE (%)	0.325	0.333	0.345
FONDI REZERVE: 04910	8,500	9,000	9,500
FONDI KONTINGJENCËS NË PËRQINDJE (%)	0.325	0.333	0.345
FONDI KONTINGJENCËS: 04940	8,500	9,000	9,500
TOTALI FONDEVE NË PËRQINDJE (%)	99.27%	99.24%	99.21%
TOTALI I FONDEVE REZERVE + KONTIGJENCË	0.73%	0.76%	0.79%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

Nr. 1882 Prot.

Tiranë, më 10/07/2026

UDHËZIM PLOTËSUES

Nr. 17 Datë 10/07/2026

“PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM VENDOR 2027-2029”

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar Ministri i Financave:

UDHËZON

- I. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029**
1. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029, të miratuara nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore do të merren në konsideratë për hartimin e buxhetit të vitit 2027.
 2. Parashikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore mbështetet në legjislacionin aktual në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, si dhe në ligjin nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar. Bashkëlidhur këtij udhëzimi, gjeni Manualin për parashikimin e të ardhurave nga burimet e veta për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
 3. Transferta e pakushtëzuar sektoriale do të jetë në përputhje me nivelin e financimit të miratuar në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2027-2029. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme do të jetë sipas detajimit të parashikimit për vitet 2027-2029, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
 4. Efekti i rritjes së pagave për funksionet e financuara me transfertë sektoriale dhe për punonjësit e administratës së bashkisë do të reflektohet në transfertën që do ti akordohet njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2027.

5. Niveli i transfertës së pakushtëzuar dhe i transfertës së pakushtëzuar sektoriale për vitet 2027-2029, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në pushtetin vendor deri në vitin 2026.
6. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar/pakushtëzuar sektoriale do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës financiare përkatëse.
7. Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2027-2029 i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 516 datë 30.06.2026 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 9, datë 15.1.2026, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kuadrit makroekonomik dhe fiskal për periudhën 2027-2029", përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029. Ai pasqyron parashikime të treguesve ekonomik dhe financiar të buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime të burimeve që njësia e vetëqeverisjes vendore do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.
8. Këto vlerësime sigurojnë bazën për njësitë e vetëqeverisjes vendore për të përcaktuar tavanet e shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm.
9. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore duhet të përfshijnë në Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029, planin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.
10. Procesi i miratimit të PBA-së 2027-2029 përfundimtare dhe Buxhetit Vjetor, do të realizohet nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor.
11. Programi Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 duhet të hartohet në përputhje me programet e miratuara me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar.
12. Bashkitë: Korçë, Gjirokastrë, Mirditë, Berat, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Shkodër, Shijak, Belsh, Fier, Patos, Fushë Arrëz, Skrapar, Mat, Delvinë dhe Qarqet: Shkodër, Gjirokastrë, Korçë, do të vijojnë me fazën e dytë të PBA-së sipas metodologjisë së re të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave nr.7 datë 27.02.2026.

II. Afatet për Përgatitjen e Buxhetit

1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi, bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga buxheti i shtetit.
2. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik.
3. Njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësisë, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave gjatë fazës së parë, brenda datës 15 shtator

4. Ministria e Financave zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 tetor. Në përfundim të këtyre takimeve, sipas rastit, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të programit buxhetor afatmesëm, brenda datës 20 tetor 2026.

III. Mbështetja Këshillimore për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

1. Ministria e Financave, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e PBA 2027-2029, vë në dispozicion për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore adresat e e-mailit: Fran.Brahimi@financa.gov.al, Elidona.Durmishi@financa.gov.al.
2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund ti drejtohen në çdo kohë Ministrisë së Financave për zgjidhjen e çdo problematike që shfaqet në lidhje me hartimin e programit buxhetor afatmesëm dhe plotësimin e formateve të PBA-së në fazën e dytë dhe fazën përfundimtare sipas Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor.

